

VENDIM
Nr.829, datë 4.6.2008

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “SHKOLLA
E LARTË EUROPIANE PËR TURIZMIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin” do të organizohet në dy fakultete, si më poshtë vijon:

a) Fakulteti i Turizmit, i cili do të ofrojë:

- programe studimi, të ciklit të parë, në:

i) ekonominë e turizmit, me drejtimet ekonomi turizmi dhe politikat e turizmit;

ii) administrim të shërbimeve turistike, me drejtimet restoranteri dhe hoteleri.

- programe studimi “Master i nivelit të parë” (MNP) në:

i) hoteleri;

ii) turizëm.

b) Fakulteti i Shkencave të Teknologjisë Informatike dhe Komunikimit, i cili do të ofrojë:

- programe studimi, të ciklit të parë, në:

i) teknologji dhe informacion;

ii) komunikim dhe gjuhë biznesi.

- programe studimi “Master i nivelit të parë” (MNP) në:

i) teknologji informacioni dhe komunikimi.

3. Programet e studimeve, që organizohen pranë institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin”, janë me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit, të ciklit të parë, është 3 vjet dhe kohëzgjatja normale e programeve të studimit “Master i nivelit të parë” është 1 vit.

4. Në përfundim të studimeve, në programet e studimit, të ciklit të parë, lëshohet “Diploma e nivelit të parë” (DNP), përkatësisht:

a) në turizëm, me drejtim ekonomia e turizmit;

b) në turizëm, me drejtim politikat e turizmit;

c) në administrim të shërbimeve turistike, me drejtim restoranteri;

ç) administrim të shërbimeve turistike, me drejtim hoteleri;

d) në teknologji dhe informacion;

dh) në komunikim dhe gjuhë biznesi.

5. Në përfundim të studimeve, në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, lëshohet diploma “Master i nivelit të parë” (MNP), përkatësisht:

a) në hoteleri;

b) në turizëm;

c) në teknologji informacioni dhe komunikimi.

6. Ngarkohet institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

7. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin”, do ta

fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin për këtë qëllim.

8. Ndryshime në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe elementet e tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Europiane për Turizmin” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara ligjore.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha